



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe nenit 23, paragrafi 2 të Ligjit të Veprimtarisë me Valuta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11, 188/13, 97/15, 153/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi:

V E N D I M

**për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit
("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 177/21)**

1. Në Vendimin për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët të cilët nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 50/19, 181/19, 167/20, 308/20 dhe 88/21), në pikën 4, paragrafi 1 ndryshohet si më poshtë:

"Rezidentët, personat juridikë dhe fizikë, mund të çelin lirshëm dhe të kenë llogari në institucione të pagesave ose institucione të parave elektronike jashtë vendit vetëm për qëllime komerciale, pra për blerje/shitje të mallrave dhe të shërbimeve në mënyrë elektronike. Transferet e mjeteve në llogaritë në institucionet e pagesave ose institucionet e parave elektronike jashtë vendit në bazë të blerjes së mallrave dhe të shërbimeve në mënyrë elektronike nuk duhet të kalojnë 2500 euro për person në baza mujore".

2. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

**O nr. 02-15/XI-4/2021
29 korrik 2021
Shkup**

**Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska**